



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.17, datë 22/12/2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE
SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR
QËLLIME TË NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “SHOQËRIA
KONCESIONARE G2 INFRA” SH.P.K., ME VENDNDODHJE:
BASHKIA VORË, QARKU TIRANË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme, të subjektit “Shoqëria Koncesionare G2 Infra” sh.p.k., me vendndodhje: Bashkia Vorë, Qarku Tiranë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor:

- $X=475388.7$
- $Y=4587262.5$
- $Z=33\text{ m}$

- Prurja mesatare : $Q_{\text{mes}}=3.5\text{ l/sek}$

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q=0.22\text{ l/sek}$

- Qëllimi i përdorimit : Për qëllime të ndryshme në funksion të aktivitetit në shërbim të Procesit të Operimit të Aksit rrugor ‘Thumanë –Kashar’ ku janë ndërtuar Stacionet e “Tolleve”.

- Thellësia e pus-shpimit: 50 m

- Thellësia e vendosjes së pompës : 35 m

- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

- Pika 1 (Shkarkim godina e operimit)
 $X-475298.9$; $Y-4587308.9$; $Z-32.29\text{m}$
- Pika 2 (Shkarkim zyra e mirmbajtjes)
 $X-475438.7$; $Y-4587291.9$; $Z-32.37\text{m}$
- Pika 3 (Shkarkim magazina)
 $X-475460.0$; $Y-4587287.5$; $Z-32.53\text{m}$
- Pika 4 (Shkarkim Drejtimi Jug)
 $X-475047.2$; $Y-4587032.2$; $Z-32.39\text{m}$
- Pika 5 (Shkarkim Drejtimi Veri)
 $X-475085.9$; $Y-4587569.5$; $Z-31.89\text{m}$

- Prurja që shkarkohet (l/s)= 0.138 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBLISHËM

EMILJAN JANI

